FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 88 **Datë 13 qershor 2014**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 349, datë 4.6.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë".....	3577
Vendim i KM nr. 351, datë 4.6.2014	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në përdorim të shoqërisë "Elber", sh.p.k., Elbasan, të cilat kalojnë në pronësi të bashkisë Elbasan.....	3577
Vendim i KM nr. 353, datë 4.6.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 173, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2014".....	3585
Udhëzim i KM nr. 1, datë 4.6.2014	Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit.....	3585
Urdhër i MD nr. 326, datë 13.6.2014	Për shpalljen e vendeve vakant, për ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, sipas njësive vendore.....	3586

VENDIM
Nr. 349, datë 4.6.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 138, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSVE CIVILË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9 e 69 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, shkronja "g" e pikës 1 të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"g) Një përfaqësues i shoqërisë civile, i zgjedhur nga ministri përgjegjës për administratën publike, nga radhët e organizatave jofitimprurëse me reputacion. Përvoja e këtij përfaqësuesi në organizatën përkatëse duhet të ketë qenë e lidhur me studime për administratën publike dhe/ose bashkëpunime me të.

Zgjedhja e përfaqësuesit nga shoqëria civile bëhet nga ministri përgjegjës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 351, datë 4.6.2014

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË SISTEMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, NË PËRDORIM TË SHOQËRISË "ELBER", SHPK, ELBASAN, TË CILAT KALOJNË NË PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3/e, 5, 8, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001,"Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në përdorim të shoqërisë "Elber", sh.p.k., Elbasan, të cilat kalojnë në pronësi të bashkisë Elbasan, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PASQYRA 1
Punimet dhe mjetet

1. Kapitulli I: Mjetet ekzistuese
2. Kapitulli II: Mjetet e ujërave të zeza
3. Kapitulli III: Punimet
4. Kapitulli IV: Mjetet e reja

Kapitulli I: Facilitetet ekzistuese

Inventar i Ndërmarrjes së Ujësjellësit Elbasan
Përmbledhje

116

Zëvendësim i vlerës së makinerive dhe ndërtesave me çmimet e 1999-ës		
	Lekë	**DM**
Ndërtesat	653.811.777	9.080.719
Makineri dhe pajisje	81.638.823	1.133.873
Automjetet	14.633.107	203.238
Tuba dhe rakoderi	950.581.060	13.202.515
TOTALI		**23.620.344**

117 Norma e këmbimit 1.00 DM=72.00 lekë është përdorur gjatë këtyre pasqyrave (përveç në pasqyrën 15 (Modeli i financimit) si
118 bazë e këmbimit në mes markës gjermane dhe lekut.

119

Inventari i Ndermarrjes se Ujesjellesit Elbasan
Ndertesat

	Ndertesat			Kosto fillestare e ndertimitt (1965-1970)		Kosto e ndertimit e rivleresuar per 1999		
No.	Pershkrimi	Njesi	Çmimi Leke	Sasia	Vlera (LEKE)	Vlera (Leke)	(DM)	DM
	Strukturat per tu mirembajtur pas rehabilitimit					**Vite pune 50 vjet; vite pune te mbetura 15vjet**		**Investim i nevojshem ne 2015 per te zgjatur vitet e punes me 30 vjet**
1	Stacioni i Pompimit poshte	cope	400.000	1	400.000	23.200.000	322.222	me çmimet e 1999
2	Rezervuari 1000m³	cope	255.000	1	255.000	14.790.000	205.417	Kryesisht suvatim i brendshem i depove
3	Puseta e grumbullimit	cope	32.000	1	32.000	1.856.000	25.778	
4	Dhoma e operatoreve	cope	5.825	1	5.825	337.850	4.692	
5	Dhoma e rojes	cope	7.000	1	7.000	406.000	5.639	
6	Rezervuari Kraste 2000m³	cope	746.000	3	2.238.000	129.804.000	1.802.833	
7	Rezervuari Kraste 500m³	cope	200.000	1	200.000	11.600.000	161.111	
8	Dhoma kryes. e shpernd. Kraste	cope	45.000	1	45.000	2.610.000	36.250	
9	Depo Kraste e Vogel 600m³	cope	240.000	2	480.000	27.840.000	386.667	
10	Depo Kraste e Vogel 2000m³	cope	400.000	1	400.000	23.200.000	322.222	
11	Dhoma kryes. e shperndarjes	cope	20.000	1	20.000	1.160.000	16.111	
12	Dhoma e rojes	cope	5.000	1	5.000	290.000	4.028	
13	Depo 1000 m3 (aksioni)	cope	255.000	1	255.000	14.790.000	205.417	
14	Depo 400 m3 (aksioni)	cope	10.000	1	130.000	7.540.000	104.722	
15	Dhoma e rojes	cope	2.000	1	2.000	116.000	1.611	
16	Pusete manovrimi Zaranike	cope	416.000	1	416.000	24.128.000	335.111	
17	Pusete manovrimi qytet	cope	408.000	4	1.632.000	94.656.000	1.314.667	
18	Pusete manovrimi RS	cope	105.000	1	105.000	6.090.000	84.583	
19	Pusete manovrimi Inst.	cope	58.000	1	58.000	3.364.000	46.722	
	TOTAL					**387.777.850**	**5.385.803**	**300.000**
	Struktura per tu zevendesuar 2015							
20	StP viti 1990	cope	40.750	2	81.500	326.000	4.528	
21	St. P viti 1990	cope	100.000	1	100.000	400.000	5.556	
22	St. P viti 1993	cope	301.000	1	301.000	1.204.000	16.722	
23	Pusete 92	cope	597.524	1	597.524	2.390.096	33.196	
24	Depo klori Mengel	cope	0	1	596.775	2.387.100	33.154	
25	Dhoma e rojes Frigoriferi	cope	0	1	300.000	1.200.000	16.667	
26	Depo 50m³ viti 1990	cope	12.000	2	24.000	96.000	1.333	
27	Pusete manovrimi viti 1997	cope	90.500	6	543.000	2.172.000	30.167	
	TOTAL					**10.175.196**	**141.322**	**141.322**

120

Inventari i Ndermarrjes se Ujesjellesit Elbasan
Ndertesat

Struktura per tu braktisur								
28	Stacioni qendror i pompimit	cope	165000	1	165.000	9.570.000	132.917	
29	Stacion pompimi 132	cope	158.000	1	158.000	9.164.000	127.278	
30	Stacion pompimi Alkodi	cope	150.000	1	150.000	8.700.000	120.833	
31	Stacion pompimi No.6	cope	150.000	1	150.000	8.700.000	120.833	
32	Stacion pompimi No.4	cope	48.000	1	48.000	2.784.000	38.667	
33	Pus me pompe vertikale	cope	12.000	1	12.000	696.000	9.667	
34	Dhoma e klorinimit	cope	16.000	1	16.000	928.000	12.889	
35	Rrethimi i St. P	m²	11	1.519	16.101	933.881	12.971	
36	Pusete me mates uji	m²	4.000	1	4.000	232.000	3.222	
37	Porte metalike	cope	600	1	600	34.800	483	
38	St. P No.1 (frigoriferi)	cope	1.500.000	1	1.500.000	87.000.000	1.208.333	
39	St. P No.2 (frigoriferi)	cope	590.000	1	590.000	34.220.000	475.278	
40	Pusete grumbullimi	cope	32.000	2	64.000	3.712.000	51.556	
41	Dhome klorinimi	cope	5.000	1	5.000	290.000	4.028	
42	Pusete manovrimi	cope	2.000	1	2.000	116.000	1.611	
43	Poret metalike	cope	500	2	1.000	58.000	806	
44	St. P kryesor Kraste e Vogel	cope	750.400	1	750.400	43.523.200	604.489	
45	Pusete grumbullimi	cope	32.000	1	32.000	1.856.000	25.778	
46	Pusete me mates uji	cope	4.000	1	4.000	232.000	3.222	
47	Porte metalike	cope	600	1	600	34.800	483	
48	Pusil No. 4	cope	500	1	500	29.000	403	
49	St. P Vullnetar	cope	135.000	1	135.000	7.830.000	108.750	
50	St. P Q. Guranjaku	cope	8.500	1	8.500	493.000	6.847	
51	Rrethimi Kraste	cope	11	1.110	11.766	682.428	9.478	
52	Porte metalike Kraste	cope	1.000	1	1.000	58.000	806	
53	Pusete manovrimi	cope	200	2	400	23.200	322	
54	Pusete manovrimi	cope	4.000	1	4.000	232.000	3.222	
55	Rrethimi i depos	m²	11	10.000	106.000	6.148.000	85.389	
56	Depo 50 m3 (aksioni)	cope	36.000	1	36.000	2.088.000	29.000	
57	Rrethimi i St. P (aksioni)	cope	25.000	1	25.000	1.450.000	20.139	
58	Rrethimi i depos (aksioni)	m²	11	900	9.540	553.320	7.685	
59	Rrethimi i St. P	cope	223.000	1	223.659	12.972.222	180.170	
60	Rrethimi i St. P Kraste	cope	150.200	1	150.200	8.711.600	120.994	
61	Garazh	cope	27.800	1	27.800	111.200	1.544	
62	Garazh	cope	0	1	55.000	220.000	3.056	
63	Stalle + garazh, zyre, kopesht	cope	368.020	3	368.020	1.472.080	20.446	
	Total				4.831.086	255.858.731	3.553.593	

	Total	9.080.719	441.322

122

Inventari i Ndermarrjes se Ujesjellesit Elbasan
Makineri dhe Pajisje

	Makineri dhe Pajisje				Kosto fillestare (1965-1970)	Kosto fillestare e rivleresuar me 1999		
No.	Pershkrimi	Njesi	Cmimi Leke	Sasia	Vlera	Leke	DM	Vlera e mbeturinave (DM)
	Pajisje per tu braktisur							
1	Pompe DK-400-11	cope	50.000	6	300.000	16.500.000	229.167	
2	Pompe DK-400-11	cope	39.600	5	198.000	10.890.000	151.250	
3	Pompe DK-400-11	cope	39.600	4	158.400	8.712.000	121.000	
4	Pompe 10PN Alkodi	cope	20.000	3	60.000	3.300.000	45.833	
5	Pompe 200-D-20	cope	14.000	1	14.000	770.000	10.694	
6	Pompe Jugosllave 17 KPP 2	cope	32.000	2	64.000	3.520.000	48.889	
7	Pompe vertikale kineze	cope	27.000	3	51.000	2.805.000	38.958	
8	Pompe 3K6	cope	8.240	1	8.240	453.200	6.294	
9	Pompe pa motor	cope	18.000	1	18.000	990.000	13.750	
10	Pompe emergjence	cope	2.000	2	4.000	220.000	3.056	
11	Pompe emergjence	cope	3.000	1	3.000	165.000	2.292	
12	Pompe 70 MT	cope	20.000	1	20.000	1.100.000	15.278	
13	Panel komandimi TN Mengel	cope	5.000	9	45.000	2.475.000	34.375	
14	Panel komandimi TN Friforiferi	cope	3.000	16	48.000	2.640.000	36.667	
15	Panel komandimi Kraste e Vogel	cope	3.000	8	24.000	1.320.000	18.333	
16	Celes dore	cope	1.100	6	6.600	363.000	5.042	
17	Panel komandimi TU Frigoriferi	cope	3.300	2	6.600	363.000	5.042	
18	Panel komandimi TU Alkodi	cope	2.900	1	2.900	159.500	2.215	
19	Panel komandimi TU PS 132	cope	10.320	2	20.640	1.135.200	15.767	
20	Panel komandimi TU PS 6	cope	2.900	1	2.900	159.500	2.215	
21	Panel komandimi TU PS Aksioni	cope	2.900	1	2.900	159.500	2.215	
22	Panel ndricimi	cope	450	3	1.350	74.250	1.031	
23	Panel operimi	cope	600	2	1.200	66.000	917	
24	Pompe kineze ZDF-70	cope	16.409	3	49.227	2.707.485	37.604	
25	Pompe me vakum	cope	30.000	1	30.000	1.650.000	22.917	
26	Pompe me motor 18-22	cope	5.200	2	10.400	572.000	7.944	
27	Pompe 2K6	cope	2.620	1	2.620	144.100	2.001	
28	Pompe D8DA	cope	70.793	1	70.793	3.893.615	54.078	
29	Pompe elektrike 2PK 6	cope	7.280	1	7.280	400.400	5.561	
30	Pompe elektrike 110kw	cope	65.000	1	65.000	3.575.000	49.653	
31	Pompe kineze	cope	555.000	1	555.000	2.775.000	38.542	
32	Celes 100 A	cope	4.180	1	4.180	229.900	3.193	
33	Celes 150 A	cope	1.551	1	1.551	85.305	1.185	
34	Celes DZ 250 A	cope	1.209	2	2.418	132.990	1.847	
35	Celes 250 A	cope	6.549	2	13.098	720.390	10.005	
	Total					75.226.335	1.044.810	50.000

123

124

Inventari i Ndermarrjes se Ujesjellesit Elbasan
Makineri dhe Pajisje

	Pajisje per tu zevendesuar 2010							
36	Transformator 560KW	cope	157.996	1	157.996	1.579.960	21.944	
37	Komplet saldimi i levizshem me gjenerator	cope	32.000	2	64.000	640.000	8.889	
38	Trkendesh hidraulik	cope	704	1	704	21.120	293	
39	Vinc i vogel 5 ton	cope	2.000	6	12.000	120.000	1.667	
40	Komplet saldimi me gaz	cope	980	1	980	9.800	136	
41	Makine llogaritese	cope	3.900	5	19.500	58.500	813	
42	Makine llogaritese	cope	10.322	2	20.644	61.932	860	
43	Makine llogaritese	cope	200	4	800	2.400	33	
44	Pompe dore	cope	500	2	1.000	10.000	139	
45	Pompe e zhytur	cope	20.000	1	20.000	200.000	2.778	
46	Pompe elektrike Gjergjan	cope	100.000	1	100.000	1.000.000	13.889	
47	Morsete tavoline	cope	5.000	1	5.000	50.000	694	
48	Trapan	cope	2.000	1	2.000	20.000	278	
49	Komplet radio stacioni	cope	248.000	1	248.000	297.600	4.133	
50	Radio komunikimi	cope	108.000	1	108.000	129.600	1.800	
51	Radio komunikimi	cope	65.000	5	345.000	414.000	5.750	
52	Radio komunikimi	cope	56.000	10	560.000	672.000	9.333	
53	Radio Motorola	cope	84.180	1	84.180	101.016	1.403	
54	Radio Motorola	cope	68.320	1	68.320	81.984	1.139	
55	Radio Motorola	cope	84.180	1	84.180	101.016	1.403	
56	Pompe elektrike	cope	70.800	1	70.800	84.960	1.180	
57	Trapan dore	cope	27.000	1	27.000	270.000	3.750	
58	Gjenerator 22 KW	cope	7.000	1	7.000	105.000	1.458	
59	Gur fleksibel	cope	23.000	1	23.000	27.600	383	
60	Depo klorinimi A	cope	175.000	1	175.000	210.000	2.917	
61	Radio Motorola	cope	70.000	1	70.000	84.000	1.167	
62	Matravide hidraulike	cope	22.500	1	22.500	27.000	375	
63	Trapan elektrik	cope	27.500	1	27.500	33.000	458	
	Total					6.412.488	89.062	

Total	**1.133.873**

125

126

Inventari i Ndermarrjes se Ujesjellesit Elbasan
Automjetet

	Automjetet			Kosto fillestare (1995-1999)			Vite pune te mbetura	
No.	Pershkrimi	Njesi	Cmimi Leke	Sasia	Vlera Leke	DM	vitet	
1	Mjeti "Praga"	cope	120000	1	120.000	1.667	2	per t'iu dorezuar ujesjellesit te fshatit
2	Mjeti "Ford"	cope	490500	1	490.500	6.813	2	per t'iu dorezuar ujesjellesit te fshatit
3	Veture "Mitsubishi"	cope	599500	1	599.500	8.326	3	
4	Ekskavator "Fiat Hitachi"	cope	3978200	1	3.978.200	55.253	8	per t'iu dorezuar ujesjellesit te fshatit
5	Motociklete "Honda"	cope	100000	1	100.000	1.389	2	per t'iu dorezuar ujesjellesit te fshatit
6	"Iveco"	cope	5840457	1	5.840.457	81.117	5	per t'iu dorezuar ujesjellesit te fshatit
7	"Benz"	cope	3272000	1	3.272.000	45.444	4	
8	Biciklete	cope	7044	33	232.450	3.228	4	
	Total				**14.633.107**	**203.238**		

127

128
129

Inventari i Ujesjellesit Elbasan
Tuba dhe Rakorderi

	Materialet			Kosto fillestare		Kosto fillestare e rivleresuar per 1999	
No.	Pershkrimi	Njesia	Cmimi Leke	Sasia	Vlera	Vlera perfshi shtrimin (Leke)	DM
1	Tub celiku 1985	ton	4.180,0	129	537.130	46.581.250	646.962
2	Tub celiku 1985	ton	4.180,0	20	83.600	7.250.000	100.694
3	Tub celiku 1985	ton	4.180,0	28	117.040	10.150.000	140.972
4	Tub celiku 1985	ton	4.180,0	6	25.080	2.175.000	30.208
5	Tub celiku (Kraste e madhe) 1985	ton	4.180,0	60	250.800	21.750.000	302.083
6	Tub celiku 1985	ton	4.180,0	3	12.540	1.087.500	15.104
7	Tub celiku 1985	ton	4.180,0	3	12.540	1.087.500	15.104
8	Tub celiku 1990	ton	5.330,0	26	140.179	9.533.750	132.413
9	Tub celiku 1990	ton	6.171,0	56	344.589	20.242.000	281.139
10	Tub celiku Gjergjan	ton	4.180,0	3	12.540	1.087.500	15.104
11	Tub celiku 1990	ton	4.180,0	53	221.481	19.212.500	266.840
12	Tub celiku 1990	ton	11.053,3	5	53.056	1.740.000	24.167
13	Tub celiku 1970	ton	vleresuar, jo ne inventar	1.255		454.937.500	6.318.576
	Total					**596.834.500**	**8.289.368**
	Tuba celiku ekuivalent ne metra 25-30 vjet, vitet e mbetura ne sherbim 35 vjet						
14	DN500	m	25.157,5	2.350		59.120.125	821.113
15	DN400	m	14.318,8	20.150		288.522.813	4.007.261
16	DN350	m	14.137,5	2.750		38.878.125	539.974
17	DN250	m	9.606,3	6.470		62.152.438	863.228
18	DN200	m	6.198,8	6.310		39.114.113	543.252
19	DN175	m	6.235,0	10.760		67.088.600	931.786
20	DN150	m	5.292,5	3.790		20.058.575	278.591
21	DN100	m	3.179,1	3.240		10.300.365	143.061
22	DN80	m	2.450,5	4.735		11.603.118	161.154
	Total					**596.838.270**	**8.289.420**
	Plotesisht te zevendesuar me tuba PE						
23	Tuba te galvanizuar 1990	ton	7.090	8	53.459	2.111.200	29.322
24	Tuba te galvanizuar 1990	ton	1.049,0	12	12.483	3.332.000	46.278
25	Tuba te galvanizuar 1985	ton		19		5.443.200	75.600
26	Tuba te galvanizuar 1970		vleresuar, jo ne inventar	277		77.560.000	1.077.222
	Total					**88.446.400**	**1.228.422**

Inventari i Ndermarjes se Ujesjellesit Elbasan

Tuba dhe Rakorderi

	Plotesisht te zevendesuara nga Saracineska te Reja (instalime nen toke) vite ne pune 40 vjet						
27	Saracineske DN 400	cope	2900	14	40.600	1.339.800	18.608
28	Saracineske DN 350	cope	2584	9	23.256	767.448	10.659
29	Saracineske DN 250	cope	1850	1	1.850	61.050	848
30	Saracineske DN 200	cope	1416	8	11.328	373.824	5.192
31	Saracineske DN 150	cope	1085	5	5.425	179.025	2.486
32	Saracineske DN 100	cope	670	5	3.350	110.550	1.535
33	Saracineske DN 300	cope	2290	6	13.740	453.420	6.298
34	Valvol mos kthimi DN400	cope	3731	4	14.924	492.492	6.840
35	Valvol mos kthimi DN200	cope	1306	4	5.224	172.392	2.394
36	Saracineske DN 350	cope	2290	5	11.450	377.850	5.248
37	Saracineske DN 400	cope	2900	15	43.500	1.435.500	19.938
38	Saracineske Valve DN 100	cope	670	2	1.340	44.220	614
39	Valvol mos kthimi	cope	3731	6	22.386	738.738	10.260
40	Saracineske DN 400	cope	2900	11	31.900	1.052.700	14.621
41	Saracineske DN 300	cope	2.290	6	13.740	453.420	6.298
42	Saracineske DN 200	cope	1.416	3	4.248	140.184	1.947
43	Saracineske DN 100	cope	670	6	4.020	132.660	1.843
44	Saracineske DN 400	cope	2.900	7	20.300	669.900	9.304
45	Saracineske DN 200	cope	1.416	13	18.408	607.464	8.437
46	Saracineske Valve DN 500	cope	6.906	3	20.718	683.694	9.496
47	Saracineske DN 400	cope	2.900	18	52.200	1.722.600	23.925
48	Saracineske DN 250	cope	2.584	6	15.504	511.632	7.106
49	Saracineske DN 300	cope	2.250	8	18.000	594.000	8.250
50	Saracineske DN 250	cope	1.850	1	1.850	61.050	848
51	Saracineske DN 300	cope	1.416	8	11.328	373.824	5.192
52	Saracineske DN 150	cope	1.085	1	1.085	35.805	497
53	Saracineske DN 100	cope	670	4	2.680	88.440	1.228
54	Saracineske DN 200	cope	1.016	5	7.080	233.640	3.245
55	Saracineske DN 150	cope	1.085	66	71.610	2.363.130	32.821
56	Valvol mos kthimi DN 200	cope	1.306	1	1.306	43.098	599
57	Saracineske DN 100	cope	670	1	670	22.110	307
58	Saracineske DN 200	cope	1.416	8	11.328	373.824	5.192
59	Saracineske DN 200	cope	1.416	4	5.664	186.912	2.596
60	Saracineske DN 400	cope	2.858	3	8.574	282.942	3.930
61	Saracineske DN 250	cope	1.950	2	3.900	128.700	1.788
62	Saracineske DN 150	cope	1.821	3	5.463	180.279	2.504
63	Saracineske DN 120	cope	676	1	676	22.308	310
64	Saracineske DN 80	cope	920	1	920	30.360	422
65	Saracineske DN 1 1/2"	cope	65	5	325	10.725	149
66	Saracineske DN 1/2"	cope	24	41	984	32.472	451
67	Saracineske DN 100	cope	1.114	2	2.228	73.524	1.021
68	Saracineske DN 125	cope	976	4	3.904	128.832	1.789
69	Saracineske DN 125	cope	899	4	3.596	118.668	1.648
70	Saracineske	cope	178	1	178	5.874	82
71	Saracineske	cope	790	1	790	26.070	362
	Total					17.937.150	249.127

Inventari i Ndermarjes se Ujesjellesit Elbasan
Tuba dhe Rakorderi

Tuba gize jo ne inventar, por te vleresuar, pjeserisht te zevendesuar(vite te metejshme pune 40 vjet; te zevendesuar 70 vjet)							
					zevendesuar me 2001/2002 (m)		
72	DN 250	m	9576	760	760	7.277.760	101.080
73	DN 200	m	7560	3800	3800	28.728.000	399.000
74	DN 150	m	6624	9680	5000	64.120.320	890.560
75	DN 100	m	5976	16180	8000	96.691.680	1.342.940
76	DN 80	m	5976	7745	3190	46.284.120	642.835
77	DN 60	m	5256	810	810	4.257.360	59.130
	Total						**3.435.545**

	Total	**13.202.515**

PASQYRA 1

Kapitulli II: Facilitetet e ujërave të zeza

Sistemi Inventor i Ujrave te Zeza

					Kosto Origjinale e rivleresuar per 1999	
Nr.	Pershkrimi	Cope	Sasia	Cmimi Lek	Lek	DM
1	Kanalizime DN 200-400	m	67313	3.600	242.326.800	3.365.650
2	Kanalizimer DN 500-600	m	19683	7.000	137.781.000	1.913.625
3	Kanalizime DN 800-1000	m	910	14.000	12.740.000	176.944
4	Kanalizime DN 1500-2000	m	2240	22.000	49.280.000	684.444
5	Kanal 1.4x2.4	m	1030	33.440	34.443.200	478.378
6	Çimento azbesti DN 500	m	250	7.000	1.750.000	24.306
7	Argjile e ngrire [ngurtesuar] DIA 320	m	210	3.000	630.000	8.750
8	Puseta	No	4750	64.800	307.800.000	4.275.000
9	Kanalizim i Ri 1999 DN 1000	m	2200	14.000	30.800.000	427.778
10	Makineri (2 kamione depozite me pompe,15 vjecare)	No	3	7.200.000	21.600.000	300.000
11	Baseni Dampa	No	1			
	Totali				**817.551.000**	**11.654.875**

VENDIM
Nr. 353, datë 4.6.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 173, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2014"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 3, e 7, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", si dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit nr. 173, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Nënndarja "i", e shkronjës "n" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"i) Ndërtimin dhe/ose rikonstruksionin e ambienteve që shërbejnë:

- për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;

- për mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve.".

2. Nënndarja "i" e shkronjës "nj" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"i) Ndërtimin dhe/ose rikonstruksionin e ambienteve që shërbejnë:

- për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;

- për mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve.".

3. Pas shkronjës "nj" shtohet shkronja "o", me këtë përmbajtje:

"o) Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje qendrore përmes financimit të lëndës djegëse në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë/dyn, për serrat që përdorin si lëndë djegëse naftë, dhe 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë/dyn për serrat që përdorin lëndë djegëse solar.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 1, datë 4.6.2014

PËR MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MONETARE TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME NË LLOGARI TË THESARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 589 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 43 e 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit nga llogaria e thesarit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

2. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

3. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga njësia shpenzuese përgjegjëse:

a) me fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës për njësinë shpenzuese, për shlyerjen e detyrimeve të vitit paraardhës, duke respektuar radhën e paraqitjes në njësinë shpenzuese;

b) nga të ardhura të tjera, të siguruara nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të legjislacionit përkatës, dhe të cilat shërbejnë si burime financimi për vetë njësinë.

4. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varen.

5. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik, nëpërmjet publikimit në faqen *on-line* të njësisë shpenzuese apo në forma të tjera të publikimit, që i bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar.

6. Në rastet kur njësia shpenzuese debitore ndodhet përpara detyrimeve që kanë të bëjnë me shuma të mëdha apo jotipike, atëherë, në bazë të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, i drejtohet gjykatës, për shlyerjen pjesore të detyrimit me fondet e vitit/viteve në vijim, duke bërë edhe njoftimin përkatës pranë përmbaruesit gjyqësor. Në rast pranimi, nga ana e gjykatës, të kërkesës për ekzekutimin e pjesshëm të vendimit, njësia shpenzuese gjatë planifikimit të buxhetit për vitin pasardhës parashikon si nevojë vetëm shumën e kështit/kësteve, që parashikohen të shlyhen gjatë atij viti buxhetor, në përputhje me vendimin e gjykatës.

7. Nëse gjatë vitit buxhetor ka fonde të papërdorura, përpara mbylljes së vitit buxhetor këto fonde mund të përdoren, për aq sa është e mundur, për shlyerjen e një pjese të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke respektuar radhën e paraqitjes.

8. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes vendore, të paraqitura zyrtarisht te këto njësi, ndjekin të njëjtën procedurë të përshkruar në këtë udhëzim.

9. Në rastin kur njësia shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij udhëzimi, atëherë përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit. Llogari e thesarit, sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, konsiderohet llogaria e unifikuar e thesarit në Bankën e Shqipërisë.

10. Në rastin e parashikuar në pikën 9 të këtij udhëzimi, kur përmbaruesi gjyqësor kërkon vendosjen e masës së sekuestros, ndiqet procedura e mëposhtme:

a) Përmbaruesi gjyqësor i dërgon titullarit të njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit:

- dokumentin që vërteton njoftimin e njësisë shpenzuese debitore për ekzekutimin vullnetar dhe të detyruar të detyrimit dhe marrjen dijeni nga ana e tij. Dokumentacioni është, sipas rastit, origjinal ose i noterizuar apo i vërtetuar "njësia me origjinalin", nga sekretaria e gjykatës;

- vendimin gjyqësor, i cili, në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet si titull ekzekutiv;

- kërkesën/urdhrin e zyrës së përmbarimit për vendosjen e masës së sekuestros.

b) Titullari i njësisë shpenzuese, brenda 5 (pesë) ditëve, i kërkon degës së thesarit pagesën e shumës së detyrimit nga llogaria e parashikuar në këtë udhëzim;

c) Dega e thesarit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës nga titullari i njësisë shpenzuese, bën pagesën e detyrimit.

11. Nëse titullari i njësisë shpenzuese nuk paraqet kërkesën brenda afatit të parashikuar në shkronjën "b" të pikës 10, dega e thesarit vendos masën e sekuestros në shpenzimet operative (artikulli buxhetor 602) të njësisë shpenzuese, në masën e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por pa prekur shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e institucionit, si: energji, ujë dhe materiale e shërbime speciale (artikulli 6021), të përshkruara në Manualin e Shpenzimeve Publike, të publikuara nga ministri i Financave.

12. Në asnjë rast nuk mund të vendoset masa e sekuestros mbi të ardhurat në burim të buxhetit të shtetit, pasi ato nuk janë fonde buxhetore të njësisë debitore.

13. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes qendrore, të paraqitura zyrtarisht deri më datë 31.12.2013, në Ministrinë e Financave, të shlyhen sipas procedurës së përcaktuar në vendimin nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", dhe udhëzimit përkatës, nga fondet e miratuara në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

14. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes qendrore, të paraqitura zyrtarisht te këto njësi, pas datës 31.12.2013 dhe deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, ndjekin këtë procedurë:

a) në rastin kur ka të parashikuar fonde për këtë qëllim, ekzekutohen menjëherë duke respektuar radhën e paraqitjes së vendimeve gjyqësore;

b) pjesa tjetër rregullohet si parashikim për vitin 2015, në përputhje me këtë udhëzim.

15. Udhëzimi nr. 2, datë 18.8.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", shfuqizohet.

16. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme, degët e thesarit dhe përmbaruesit gjyqësorë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 326, datë 13.6.2014

PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANT, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË NOTERËVE, SIPAS NJËSIVE VENDORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 3, të shkronjës "ç", të ligjit nr. 7829, 1.6.1994, "Për noterinë", të

ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 158, datë 9.4.2013 të Ministrit të Drejtësisë, "Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre në çdo rreth gjyqësor, si dhe mbulimin përkatës për çdo bashki, së bashku me komunat pranë saj",

URDHËROJ:

I. Shpalljen e vendeve vakant, për ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, sipas njësive vendore në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

Bashkia/komuna		**Nr. i vendeve**
Bashkia	Berat	2
Bashkia	Ura-Vajgurore	1
Bashkia	Poliçan	1
Bashkia	Peshkopi	1
Bashkia	Klos	1
Bashkia	Durrës	6
Bashkia	Shijak	2
Bashkia	Elbasan	4
Bashkia	Fier	3
Bashkia	Patos	2
Komuna	Levan	1
Bashkia	Lushnjë	3
Bashkia	Ballsh	1
Bashkia	Gjirokastër	3
Komuna	Dropull i Sipërm	1
Bashkia	Korçë	2
Komuna	Pojan	1
Bashkia	Lezhë	2
Komuna	Shëngjin	1
Bashkia	Shkodër	2
Komuna	Bushat	1
Komuna	Velipojë	1
Bashkia	Koplik	1
Bashkia	Tiranë	14
Bashkia	Kamzë	1
Komuna	Farkë	2
Komuna	Paskuqan	1
Komuna	Pezë	1
Komuna	Kashar	2
Komuna	Ndroq	1
Bashkia	Vlorë	2
Komuna	Novoselë	1
Bashkia	Sarandë	4
Bashkia	Delvinë	1

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006